

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Manaxhimit dhe Ortakëve të Shoqërisë United Quarries sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **United Quarries sh.p.k.**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

10 Maj 2019



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
Phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al

Irena Hoxha (Palo)
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	627,198	336,079
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	512,962	517,798
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	1,581,620	2,062,306
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	8,101,258	7,931,331
Inventarë	8	12,341,524	12,481,685
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	87,919	70,797
Totali i aktiveve afatshkurtra		23,252,481	23,399,996
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale		91,505,802	160,471,191
Aktive afatgjatë materiale në proces		-	4,497,834
Totali i aktiveve afatgjatë	10	91,505,802	164,969,025
Totali i aktiveve		114,758,283	188,369,021
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	11,243,285	4,063,655
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	33,439,548	89,495,424
Detyrime tatimore	13	11,161,425	447,438
Të tjera detyrime	14	5,136,447	4,458,266
Totali i detyrimeve afatgjatë		60,980,705	98,464,783
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		60,980,705	98,464,783
Kapitali			
Kapitali i themeltar		160,000,000	160,000,000
Rezerva të tjera		11,321,024	11,321,024
Rezerva ligjore		3,544,964	3,544,964
Humbje të akumuluar		(84,961,750)	(53,618,553)
Humbje e vitit		(36,126,660)	(31,343,197)
Totali i kapitalit	15	53,777,578	89,904,238
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		114,758,283	188,369,021

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	8,528,592	7,922,880
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	17	(139,196)	813,142
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	(4,920,237)	1,817,901
Total të ardhura		3,469,159	10,553,923
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(12,939,132)	(12,677,278)
1) Lënda e parë, materiale dhe sherbime direkte	19	(4,329,498)	(4,365,923)
2) Të tjera shpenzime	20	(8,609,634)	(8,311,355)
Shpenzime të personelit	21	(15,024,476)	(18,320,741)
1) Paga dhe shpërblime		(13,014,636)	(15,899,501)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,009,840)	(2,421,240)
Zhvlerësim i aktiveve afatgjata materiale	22	(4,497,834)	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(6,894,615)	(8,251,335)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(238,598)	(2,647,774)
Shpenzime financiare	25	(1,164)	8
1) Te ardhura/(Shpenzime) interesi dhe shpenzime te ngjashme		(1,164)	8
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
Humbja para tatimit		(36,126,660)	(31,343,197)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	-	-
Humbja e vitit		(36,126,660)	(31,343,197)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(36,126,660)	(31,343,197)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

UNITED QUARRIES sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali themeltar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet/humbjet e mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2017	160,000,000	3,544,964	11,321,024	(24,017,493)	(29,601,060)	121,247,435
Fitimi / Humbja e vitit					(31,343,197)	(31,343,197)
Transferime në fitime/humbje të mbartura				(29,601,060)	29,601,060	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	160,000,000	3,544,964	11,321,024	(53,618,553)	(31,343,197)	89,904,238
Fitimi / Humbja e vitit					(36,126,660)	(36,126,660)
Transferime në fitime/humbje të mbartura				(31,343,197)	31,343,197	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	160,000,000	3,544,964	11,321,024	(84,961,750)	(36,126,660)	53,777,578

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i United Quarries sh.p.k. më ___ maj 2019 dhe janë firmosur si më poshtë.

Egilda Vyshka EKO

Znj. Egilda Vyshka
Hartues i Pasqyrave Financiare

Charles Bour

Z. Charles Michael Bour
Administrator

**UNITED QUARRIES
SH.P.K. ELBASAN**

UNITED QUARRIES sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Humbja përpara tatimit	(36,126,660)	(31,343,197)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,894,615	8,251,335
Shpenzime zhvleresimi	4,497,834	2,611,188
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim/humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	4,983,941	(45,475)
<i>Ndryshimet në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzimet e shtyra	(17,122)	1,571
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(165,091)	(169,489)
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme pale te lidhura	480,686	(2,062,306)
Rënie/(rritje) në inventarë	140,161	(808,995)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	17,893,617	(2,670,614)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme pale te lidhura	(56,055,876)	26,007,368
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	678,181	(45,887)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(56,795,714)	(274,501)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	57,086,833	295,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	57,086,833	295,000
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	-	(4,448)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	(4,448)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	291,119	16,051
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	336,079	320,028
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 627,198	336,079

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "United Quarries" Shpk është regjistruar më 1 korrik 1996 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 38668 datë 27.06.2007.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është prodhimi dhe përpunimi i gurit gëlqeror të fraksionuar, tregëtim i tij etj.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 160,000,000 lekë i cili zotërohet nga:

- Seament Albania Sh.p.k. me 137,600 kuota ose e barabartë me 86 % të kapitalit
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me 20,950 kuota ose e barabartë me 13.09% të kapitalit
- Individë të ndryshëm në total 1,450 kuota ose e barabarte me 0.91% të kapitalit

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Elbasan me NIPT: J62904210Q.

Administratori i shoqërisë është Z. Charles Michael Bouri.

Në 31 dhjetor 2018 shoqëria kishte 22 punonjës, (2017:26).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Euro/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	5%
Instalime të përgjithshme	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	5%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në Lekë	542,800	204,672
<i>Arka</i>	63	63
<i>Banka</i>	542,737	204,609
Mjete Monetare në valutë	84,398	131,407
<i>Banka</i>	84,398	131,407
	<u>627,198</u>	<u>336,079</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë për mallra	512,962	517,798
	<u>512,962</u>	<u>517,798</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Fushe Kruja Cement Factory	1,581,620	2,062,306
	<u>1,581,620</u>	<u>2,062,306</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Tatim fitimi i parapaguar	6,199,052	6,199,052
Të tjera të arkëtueshme nga tatimet	2,196,546	1,933,879
Të arkëtueshme nga dogana	54,832	54,832
Të arkëtueshme nga sigurimet	181,075	181,075
Debitore të tjerë	2,080,941	2,085,614
TVSH për t' u rimbursuar	-	88,067
Zhvlerësim i llogarive të tjera të arkëtueshme	(2,611,188)	(2,611,188)
	<u>8,101,258</u>	<u>7,931,331</u>

Lëvizjet në zhlerësimin e llogarive të tjera të arkëtueshme:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Gjendja më 1 janar	2,611,188	-
Rimarrje për vitin	-	-
Zhvlerësimi për vitin	-	2,611,188
Gjendja më 31 dhjetor	<u>2,611,188</u>	<u>2,611,188</u>

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Materiale ndihmëse	10,167,658	10,168,531
Lëndë djegëse	195,169	195,169
Prodhim në proces	1,949,663	2,088,859
Të tjera	29,034	29,126
	<u>12,341,524</u>	<u>12,481,685</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për t' u shpërndarë - Siguracion	87,919	70,797
	<u>87,919</u>	<u>70,797</u>

UNITED QUARRIES sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lekë)

10. Aktive Aftatgjata Materiale

Kosto	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Kompjutera	Pajisje zyre	Aktive në proces	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	4,048,400	189,211,415	272,630,924	52,765,247 (2,262,600)	451,645	550,295	4,497,834	524,155,760 (2,262,600)
Pakësime								
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,048,400	189,211,415	272,630,924	50,502,647	451,645	550,295	4,497,834	521,893,160
Pakësime			(88,000,000)	(21,000,630)				(109,000,630)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	4,048,400	189,211,415	184,630,924	29,502,017	451,645	550,295	4,497,834	412,892,530
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
Gjendja më 1 janar 2017		180,857,157	127,456,456	41,390,283	448,946	533,033		350,685,875
Amortizimi i vitit		417,708	7,261,621	564,444	2,699	4,863		8,251,335
Kthim amortizimi				(2,013,075)				(2,013,075)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	181,274,865	134,718,077	39,941,652	451,645	537,896	-	356,924,135
Amortizimi i vitit		396,828	6,153,081	342,234		2,472		6,894,615
Pakësime			(30,822,470)	(16,107,386)			4,497,834	(42,432,022)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	181,671,693	110,048,688	24,176,500	451,645	540,368	4,497,834	321,386,728
<i>Vlera neto kontabël</i>								
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,048,400	7,936,550	137,912,847	10,560,995	-	12,399	4,497,834	164,969,025
Gjendja më 31 dhjetor 2018	4,048,400	7,539,722	74,582,236	5,325,517	-	9,927	-	91,505,802

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë	10,947,458	3,876,306
Furnitorë për fatura të pambërritura	295,827	187,349
	<u>11,243,285</u>	<u>4,063,655</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Elbasan Cement Factory	32,229,257	88,285,133
Seament Albania	1,210,291	1,210,291
	<u>33,439,548</u>	<u>89,495,424</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	835,505	302,926
Tatimi mbi të ardhurat personale	187,892	144,512
TVSH për t' u paguar	10,138,028	-
	<u>11,161,425</u>	<u>447,438</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga për tu paguar	4,920,666	4,270,496
Të tjera detyrime ndaj punonjësve	202,000	179,600
Detyrime të tjera	13,781	8,170
	<u>5,136,447</u>	<u>4,458,266</u>

15. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 160,000,000 LEK dhe zotërohet 100% nga ortakët:

- Seament Albania sh.p.k. me 137,600 kuota (86 % të kapitalit)
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me 20,950 (13.09 % të kapitalit)
- Individë të ndryshëm në total 1,450 kuota (0.91% të kapitalit)

Rezerva ligjore paraqitet e pa ndryshuar nga viti paraardhës, dhe paraqitet në shumën 3,544,964 Lekë. Rezerva të tjera paraqitet e pa ndryshuar nga viti paraardhës, dhe paraqitet në shumën 11,321,024 Lekë.

Shuma prej (84,961,750) Lekë përfaqëson humbjen e mbartur nga viti paraardhës. (2017: (53,618,553) Lekë)

Rezultati neto i vitit ushtrimor është humbje në shumën (36,126,660) Lekë.

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga shitja e gurit	8,528,592	7,922,880
	<u>8,528,592</u>	<u>7,922,880</u>

17. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	(139,196)	813,142
	<u>(139,196)</u>	<u>813,142</u>

18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Në këtë zë paraqiten të ardhurat e tjera të shfrytëzimit të realizuara nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura të tjera	-	1,802,187
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	(4,983,941)	45,475
Të ardhurat nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	132,053	2,811
Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	(68,349)	(32,572)
	<u>(4,920,237)</u>	<u>1,817,901</u>

18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

Rezultati neto nga shitja e AAM-ve paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Te ardhura nga shitja	57,086,833	295,000
Vlera kontabël e aktiveve të shitura	(62,070,774)	(249,525)
Rezultati neto	(4,983,941)	45,475

19. Lëndë të para materiale dhe shërbime direkte

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbimet detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Materiale ndihmëse	51,147	83,974
Lëndë djegëse	6,667	3,674
Shpenzime për energji dhe ujë	2,525,454	2,656,065
Shpenzime transporti	1,545,808	1,436,022
Taksa minerare	200,422	186,188
	4,329,498	4,365,923

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shërbimi rojes private	5,664,720	5,349,630
Taksa dhe tarifa vendore	1,837,928	1,551,066
Mirëmbajtje dhe riparime	-	419,752
Sigurime	344,578	374,766
Konsulenca dhe shërbime nga të tretë	409,528	315,244
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	204,080	204,140
Komisione bankare	101,182	64,947
Të tjera	47,618	31,810
	8,609,634	8,311,355

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Pagat dhe shpërblimet e personelit	13,014,636	15,899,501
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	2,009,840	2,421,240
	<u>15,024,476</u>	<u>18,320,741</u>

22. Shpenzime zhvlerësimi

Shpenzimet e zhvlerësimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime zhvlerësimi	4,497,834	-
	<u>4,497,834</u>	<u>-</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2018 është 22 (31 dhjetor 2017: 26).

23. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6,894,615	8,251,335
	<u>6,894,615</u>	<u>8,251,335</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjopa dhe dëmshpërblime	238,598	36,586
Zhvlerësim i llogarive të tjera të arkëtueshme	-	2,611,188
	<u>238,598</u>	<u>2,647,774</u>

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat dhe detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për interesa	1,164	-
Të ardhura nga interesat	-	(8)
	<u>1,164</u>	<u>(8)</u>

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<i>Fitimi para tatimit</i>	(36,126,660)	(31,343,197)
Shpenzime të panjohura	<u>4,771,942</u>	<u>2,881,774</u>
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	238,598	36,586
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	4,497,834	2,611,188
Shpenzime të tjera	35,510	234,000
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	(31,354,718)	(28,461,423)
Humbje fiskale e mbartur	(89,934,064)	(103,156,739)
Humbja fiskale e vitit	(121,288,782)	(131,618,162)
<i>Tatim fitimi @15%</i>		
Fitimi i vitit	<u>(36,126,660)</u>	<u>(31,343,197)</u>

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Fushe Kruja cement factory	1,712,508	130,888	2,062,306	-
Elbasan Cement Factory	471,882	32,701,139	-	88,285,133
Seament Albania		1,210,291	-	1,210,291
	<u>2,184,390</u>	<u>34,042,318</u>	<u>2,062,306</u>	<u>89,495,424</u>

27. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Fushe Kruja Cement Factory		30,686	1,802,090	83,502
Elbasan Cement Factory	10,234,310	37,531	7,922,977	-
	10,234,310	68,217	9,725,067	83,502

28. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.